Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Dibër, Rajoni III **217 punëmarrës informal ose 2.13 % të totalit të punëmarrësve**


⁵ Tabela nuk përmban numrin e inspektorëve sipas stukturës së Urdhërit nr. 156, datë 24.11.2020, Gjithashtu nga Drejtoria Qendrore kemi llogaritur numrin vetëm të inspektoreve të angazhuar.

Drejtoria Rajonale e ISHPSHSH-së Gjirokastrër, Rajoni VI 71 punëmarrës informal ose 1.04 % të totalit të punëmarrësve

Drejtoria Qendrore

13 punëmarrës informal ose 0.35 % të totalit të punëmarrësve

Në varësi të numrit të informalëve për numër inspektorësh mund të paraqesim këtë ilustrim:



PUNËMARRËSIT

Në lidhje me punëmarrësit e evidentuar në punë rezulton se:

52 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrëse femra.

1.3 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës që punojnë pa kontrata individuale pune.

18.5 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të siguruar në bazë të pagës minimale.

0.3 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të huaj.

0.05 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës me aftësi të kufizuar.

0.1 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës nën 18 vjeç.

0.8 % e punëmarrësve të evidentuar ishin punëmarrës të pasiguruar (informal)

0.1 % e punëmarrësve të evidentuar ishin të aksidentuar.

0.5 % e Punëmarrësve gjithsej që kryejnë punën në shtëpi.

9.4 % e Punëmarrësve gjithsej janë evidentuar që punojnë në turn të II-të (19⁰⁰-22⁰⁰)

3.2 % e Punëmarrësve gjithsej, në turn të III-të (22⁰⁰-06⁰⁰)

Sipas sektorëve dhe rajoneve kategoritë e të punëmarrësve evidentuar gjatë inspektimeve, rezultojnë:

Rajoni /Sektori i Inspektimit	Punëm arrës	Femra	Pnm/ Pa kontr ata	Pnm/page minimale	Të huaj	Me aftësi të kufizua r	Nën 18 Vjeç
Drejtoria Rajonale Tiranë-Rajoni I	146242	79034	697	17372	344	11	106
Sektori i Inspektimit Tiranë	111650	59720	482	12824	139	4	22
Sektori i Inspektimit Durrës	34592	19314	215	4548	205	7	84
Drejtoria Rajonale Vlorë-Rajoni II	32750	17783	494	8577	117	4	40
Sektori i Inspektimit, Berat	7669	4436	165	1683	9	3	1
Sektori i Inspektimit, Fier	10384	5449	142	3983	10	1	12
Sektori i Inspektimit, Vlorë	14697	7898	187	2911	98	0	27
Drejtoria Rajonale Dibër-Rajoni III	10177	2425	300	1504	118	83	0
Sektori i Inspektimit, Dibër	8264	1625	157	797	17	83	0
Sektori i Inspektimit, Kukës	1913	800	143	707	101	0	0
Drejtoria Rajonale Korçë-Rajoni IV	19114	9469	666	6504	72	12	9
Sektori i Inspektimit, Korçë	9963	5400	429	3847	22	1	0
Sektori i Inspektimit, Elbasan	9151	4069	237	2657	50	11	9
Drejtoria Rajonale Shkodër-Rajoni V	8621	4913	508	5074	34	0	0
Sektori i Inspektimit, Shkodër	5722	3383	313	3416	19	0	0
Sektori i Inspektimit, Lezhë	2899	1530	195	1658	15	0	0
Drejtoria Rajonale Gjirokastrë-Rajoni VI	6807	3187	242	2358	10	1	16
Sektori i Inspektimit, Gjirokastrë	4487	2285	105	1239	6	1	1
Sektori i Inspektimit Sarandë	2320	902	137	1119	4	0	15
Drejtoria Qendrore	3,632	1728	39	716	27	0	0
Total	227343	118539	2946	42105	722	111	171
% kundrejt Totalit		52%	1.3%	18.5%	0.3%	0.05%	0.1%


PUNËMARRËS PA KONTRATA INDIVIDUALE PUNE

Një nga format e informalitetit në punësim është të punuarit pa një marrëveshje pune të shkruar. Gjatë kësaj periudhe janë evidentuar gjithsej 2946 punëmarrës pa kontrata individuale pune në inspektimet total privat dhe shtet, ose rreth 1.3% e totalit të këtyre punëmarrësve të evidentuar gjithsej në inspektimet e realizuara.

Sipas rajoneve dhe sektorëve kjo e dhënë pasqyrohet si më poshtë

Inspektime Privat + Shtet	Subjekte Privat + Shtet	Punëmarrës	Pa kontrata	% e punm. Pa kontrata individuale
Drejtoria Rajonale Tiranë-Rajoni I	5422	146242	697	0.5%
Sektori i Inspektimit Tiranë	4411	111650	482	0.4%
Sektori i Inspektimit Durrës	1011	34592	215	0.6%
Drejtoria Rajonale Vlorë-Rajoni II	1411	32750	494	1.5%
Sektori i Inspektimit, Berat	257	7669	165	2.2%
Sektori i Inspektimit, Fier	605	10384	142	1.4%
Sektori i Inspektimit, Vlorë	549	14697	187	1.3%
Drejtoria Rajonale Dibër-Rajoni III	565	10177	300	2.9%
Sektori i Inspektimit, Dibër	299	8264	157	1.9%
Sektori i Inspektimit, Kukës	266	1913	143	7.5%
Drejtoria Rajonale Korçë-Rajoni IV	1320	19114	666	3.5%
Sektori i Inspektimit, Korçë	723	9963	429	4.3%
Sektori i Inspektimit, Elbasan	597	9151	237	2.6%
Drejtoria Rajonale Shkodër-Rajoni V	707	8621	508	5.9%
Sektori i Inspektimit, Shkodër	482	5722	313	5.5%
Sektori i Inspektimit, Lezhë	225	2899	195	6.7%
Drejtoria Rajonale Gjirokastrë-Rajoni VI	655	6807	242	3.6%
Sektori i Inspektimit, Gjirokastrë	447	4487	105	2.3%
Sektori i Inspektimit, Sarandë	208	2320	137	5.9%
Drejtoria Qendrore	74	3,632	39	1.1%
Total	10,154	227343	2946	1.3%

Në grafikun e mëposhtëm jepen treguesi i punëmarrësve të pasiguruar dhe atyre që edhe pse rezultojnë të deklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore, punonin pa një kontratë pune të shkruar.



Të dhënat për punëmarrës pa kontratë pune vetëm në subjekte private sipas llojit të aktiviteteve ekonomike numri më i madh i punëmarrësve pa kontratë pune individuale evidentohet në llojin e aktivitetit: Tregti Hotel-Bar-Restorante me 3.1%, Ndërtim me 2.6 %, Financë Shërbime me 6.8% kundrejt numrit të punëmarrësve pa kontratë evidentuar në këto aktivitete gjatë procesit të inspektimit.

Lloji i aktivitetit		Nr Subjekte Private	Punëmarrës në subjektet private	Nr. punm. Pa kontrata individuale	% e punm. Pa kontrata individuale kundrejt punëmarreve në sub private
1	Bujqësi, pyje, peshkim	92	458	6	1.3%
2	Miniera, karriera	190	7264	68	0.9%
3	Ndërmarrje prodhuese	2489	100327	924	0.9%
4	Elektricitet, gaz, ujë	93	1524	5	0.3%
5	Tregti, hotel-bar-restorante	3619	36321	1136	3.1%
6	Ndërtim	1680	16969	441	2.6%
7	Transport, telekomunikacion	254	11491	42	0.4%
8	Financë, shërbime të sigurimeve	76	1107	75	6.8%
9	Aktivitete të tjera	1570	37355	238	0.6%
TOTAL		10063	212816	2935	1.4%

PAGA

Punësimi me pagë minimale rezulton evident në 19.7 % të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara gjatë vitit 2022.


Lloji i aktivitetit (Subjekte Private)	Subjekte private	Punëmarrës në subjektet private	Punm. të siguruar mbi pagë minimale	% kundrejt totalit të punëmarrësve
Bujqësi, pyje, peshkim	92	458	285	62.2%
Miniera, karriera	190	7264	512	7.0%
Ndërmarrje prodhuese	2489	100327	19007	18.9%
Elektricitet, gaz, ujë	93	1524	85	5.6%
Tregti, hotel-bar-restorante	3619	36321	11246	31.0%
Ndërtim	1680	16969	4362	25.7%
Transport, telekomunikacion	254	11491	1263	11.0%
Financë, shërbime të sigurimeve	76	1107	276	24.9%
Aktivitete të tjera	1570	37355	4801	12.9%
Total	10063	212816	41837	19.7%

DËNIMET ADMINISTRATIVE


2399 masat administrative janë vendosur në subjektet ekonomike të inspektuara ose në 23.6 % të subjekteve të inspektuara, ku 940 janë masa urgjente për shkelje të marrëdhënieve të punës, 98 janë masa urgjente për shkelje të sigurisë dhe shëndetit në punë, 1226 janë masa të dënimit kryesor paralajmërim dhe 135 janë masa të dënimit kryesor gjobë.

Në përqindje këto masa flasin për:

- 43.2 % e këtyre masave ndëshkuese janë “Pezullim” për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës dhe sigurisë në punë,
- 51.1 % janë “Paralajmërim”
- 5.6 % janë masa me “Gjobë”.



Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë , treguesit kanë rritje dhe cilësi inspektimi




Sipas Rajoneve të dhënat për masat administrative paraqiten si më poshtë në Inspektime Total (Private+Shtetërore).

Drejtoritë Rajonale Sektorët e Inspektimit	Inspektime Total Privat+Shtet	Subjekte me Masë Urgjente Pezullim	Nr subjekte me Gjoba	Subjekte me Paralajmerim	% inspektimeve me denime administrative në total sipas inspektimeve të çdo Sektorit/Rajoni
Drejtoria Rajonale Tiranë-Rajoni I	5422	286	45	276	11%
Sektor i Inspektimit Tiranë	4411	211	33	153	9%
Sektor i Inspektimit Durrës	1011	75	12	123	21%
Drejtoria Rajonale Vlorë-Rajoni II	1411	189	19	540	53%
Sektor i Inspektimit, Berat	257	40	4	175	85%
Sektor i Inspektimit, Fier	605	77	6	35	20%
Sektor i Inspektimit, Vlorë	549	72	9	330	75%
Drejtoria Rajonale Dibër-Rajoni III	565	140	8	162	55%
Sektor i Inspektimit, Dibër	299	111	5	115	77%
Sektor i Inspektimit, Kukës	266	29	3	47	30%
Drejtoria Rajonale Korçë-Rajoni IV	1320	277	20	184	36%
Sektor i Inspektimit, Korçë	723	145	14	97	35%

Sektori i Inspektimit, Elbasan	597	132	6	87	38%
Drejtoria Rajonale Shkodër-Rajoni V	707	98	17	28	20%
Sektori i Inspektimit, Shkodër	482	65	7	18	19%
Sektori i Inspektimit, Lezhë	225	33	10	10	24%
Drejtoria Rajonale Gjirokastër-Rajoni VI	655	41	9	19	11%
Sektori i Inspektimit, Gjirokastër	447	27	4	16	11%
Sektori i Inspektimit Sarandë	208	14	5	3	11%
Drejtoria Qendrore	74	7	17	17	55%
Total	10,154	1,038	135	1,226	23.6%

Masat administrative aplikuar në inspektimet e kryera për drejtori rajonale rezultojnë që kundrejt numrit të inspektimeve Rajoni Vlorë në 53% të insketimeve ka marrë masa administrative, Drejtoria Qëndrore në 55 % ka shkuar me masa, Rajoni Dibër në 55 % të inspektimeve ka shkuar me dënime, etj.

Grafik % e subjekteve me dënime administrative sipas llojit te aktivitetit kundrejt totalit të inspektimeve për lloj aktiviteti.



Llojet e aktivitetit ku pas inspektimit të kryer janë marrë masat administrative janë në Miniera-Karriera në 68 % të inspektimeve në këtë sektor, Ndërmarrje Prodhuese me 31 % të inspektimeve kanë shkuar me dënime administraitve, aktiviteti elektricitet gaz ujë me 28 % të subjekteve të inspektuara në këtë sektor janë me masa, Ndërtim me 24 % të inspektimeve në këtë aktivitet janë me masa dhe Tregti Hotel-Bar-Restorante 21%.

Aktivitete Ekonomike	Subjekte të inspektuara	Subjekte me Masë Urgjente Marrëdhënie Pune & Siguri Punë "Pezullim"	% Subjekte me Masë "Pezulli" kundrejt totalit Insp	Subjekt e me Paralajmërim	% subjekteve me Paralajmërim	Subjekt e me Gjobë	% Subjekte me Gjobë
Bujqësi, pyje, peshkim	94	3	3%	3	3%	0	0%
Miniera karriera	191	41	21%	83	43%	6	3.1%
Ndërmarrje Prodhuese	2,494	278	11%	445	18%	43	1.7%
Elektricitet, gaz, ujë	105	4	4%	19	18%	6	5.7%
Tregti, hotel-bar-restorante	3,620	427	12%	328	9%	22	0.6%
Ndërtim	1,680	194	12%	188	11%	29	1.7%
Transport, magazinim, telekomunikacion	256	10	4%	18	7%	2	0.8%
Financë, shërbime të sigurimeve	77	6	8%	4	5%	3	3.9%
Aktivitete të tjera	1,637	75	5%	138	8%	24	1.5%
TOTAL	10,154	1038	10%	1,226	12%	135	1.3%

Masat administrative, ndaj subjekteve të inspektuara, sipas rastit e llojit të inspektimit, janë më ndëshkuese në inspektimet rastësore, aksidenteve dhe ankesave, ku në 86.1 % të inspektimeve rastësore janë me masa administrative, 77.4 % e inspektimeve për aksident në punë janë me masa ndëshkuese dhe 40 % e inspektimeve të kryera për shkak ankese janë me masa administrative.

	Inspektime	Subjekte me masa administrative	Përqindje e subjekteve me masa kundrejt inspektimeve përkatëse
Në inspektime të programuar+ tematik(riinspektim, realizuar në turne të dytë, turn të tretë, pushim festa zyrtare, bashkëpunim me, autorizim për të mitur, autorizim ore shtese, autorizim leje pune, këshillim, të tjera (IPARD)	9238	108	1.16 %
Inspektime vetem Programuara	7,737	1540	19.9 %
Në inspektime për aksident në punë	208	161	77.4 %
Në inspektime për shkak ankese	520	208	40 %
Inspektime rastësore	188	162	86.1 %

Numri i subjekteve të sanksionuar sipas rajoneve dhe sektorëve për vitin 2022

Drejtoria Rajonale/Sektori i Inspektimit	Nr inspektimeve	Subjekte me gjoba	Vlerë (000)
Drejtoria Rajonale Tiranë-Rajoni I	5422	45	7344
Sektori i Inspektimit Tiranë	4411	33	5264
Sektori i Inspektimit Durrës	1011	12	2080
Drejtoria Rajonale Vlorë-Rajoni II	1411	19	3138
Sektori i Inspektimit, Berat	257	4	1378
Sektori i Inspektimit, Fier	605	6	510
Sektori i Inspektimit, Vlorë	549	9	1250
Drejtoria Rajonale Dibër-Rajoni III	565	8	1830
Sektori i Inspektimit, Dibër	299	5	1380
Sektori i Inspektimit, Kukës	266	3	450
Drejtoria Rajonale Korçë-Rajoni IV	1320	20	3174
Sektori i Inspektimit, Korçë	723	14	2300
Sektori i Inspektimit, Elbasan	597	6	874
Drejtoria Rajonale Shkodër-Rajoni V	707	17	6940
Sektori i Inspektimit, Shkodër	482	7	2700
Sektori i Inspektimit, Lezhë	225	10	4240
Drejtoria Rajonale Gjirokastrë-Rajoni VI	655	9	2520
Sektori i Inspektimit, Gjirokastrë	447	4	1400
Sektori i Inspektimit Sarandë	208	5	1120
Drejtoria Qendrore	74	17	3,394
Total	10,154	135	28,340

Gjatë periudhës janar-nëntor janë vendosur 135 gjoba për shkelje të dispozitave ligjore. Nga këto :

- 48 gjoba gjatë inspektimeve për shkak aksidente në punë
- 32 gjoba gjatë inspektimeve për shkak ankesa, denoncime nga të tretët
- 54 gjoba në inspektime të programuara dhe tematike
- 1 Gjobë në inspektime rastësore.

DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË STANDARTEVE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ajo ka përgjegjësi të kontrollojë dhe të verifikojë respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Për vitin 2022, në përputhje me kërkesat ligjore dhe prioritetet e saj, Drejtoria e Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, ka realizuar:

- **39** aktivitete ndërvepruese me agjensi ndërkombëtare, me qëllim forcimin e kapaciteteve të inspektimit të shërbimeve shoqërore;
- **145** kontrole, vlerësime dhe informime të ofruesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, publikë dhe jopublik.

Përgjatë vitit 2022, bazuar në Planin e Inspektimit, janë realizuar 135 inspektime të Qendrave/Shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Gjithashtu, me kërkesë, të bazuar në ligj, janë kontrolluar, paplanifikim, 10 Qendra/Shërbime të përkujdesit shoqëror. Qëllimi i inspektimeve të kryera është sigurimi i respektimit të kërkesave të standardeve të shërbimeve shoqërore, sipas llojit të shërbimit duke siguruar dhe ndikuar në cilësinë e përkujdesit për 8905 individë dhe familje në nevojë, përfitues në këto 145 Qendra/Shërbime.

Puna e Drejtorisë së Inspektimit të Standardeve të Shërbimeve Shoqërore, ka synuar që përmes kontroleve të vazhdueshme të sigurojë garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror, ruajtja e nivelit të plotësisë së treguesve të standardeve përkatëse, respektimi i të drejtave të përfituesve, trajtimi i tyre me dinjitet dhe në përputhje me nevojat e vlerësuara të çdo individi në nevojë, për qendrat e përkujdesit, funksionale prej vitesh, dhe rritja e cilësisë së shërbimit për qendrat e reja të identifikuar, si edhe kudo ku përfituesi është, në qendër, në familje, në komunitet etj, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr.121/2016, datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe Standartet e Përkujdesit Social të miratuara.

Bazuar në këtë bazë të dhënave numri i shërbimeve, llojet e përkujdesit dhe aktorët janë në total 485 shërbime, struktura dhe projekte që janë objekt ligjor kontrolli, informimi, verifikimi dhe vlerësimi të përmbushjes së treguesve të standardeve të përkujdesit. Të grupuara, këto shërbimet dhe aktorët, janë si më poshtë:

- 117 shërbime të përkujdesit rezidencial, nga të cilat 42 janë publike;
- 188 qendra/njësi të të përkujdesit komunitar, (qendra ditore, gjysmë ditore, shërbime emergjente, shërbime në familje, shërbime terapeutike të specializuara, linja të këshillimit telefonik, etj). Nga të cilat 59 klasifikohen shërbime publike;
- 119 projekte/shoqata në komunitet, për forcim kapacitetesh, asistencë e specializuar (psh. ligjore, këshillim psikologjik), kontribute dhe përfshirje në menaxhim rasti, ndihma humanitare apo paketa ndihme emergjente;
- 61 Drejtori/Sektorë/Zyra të kujdesit social në nivel bashkie, të cilat ofrojnë shërbim parashoqëror, vlerësim, referim dhe menaxhim rasti, pjesëmarrje dhe vendimmarrje në Planin e Përkujdesit (Punonjësi Social, PMF, KVMVDHF, Administratori Shoqëror, etj).
- Gjithësej 485 shërbime, struktura dhe projekte.

Në mënyrë të përmbledhur, për secilin prioritet, treguesit e arritur gjatë vitit 2022 janë:

Nr.	Prioriteti	Aktiviteti	Realizuar
1	Forcimi i kapaciteteve inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore.	Tryeza Teknike, Ëorkshop në nivel kombëtar për forcimin dhe promovimin e rolit të inspektoriatit të kujdesit shoqëror.	34
2	Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet informimit, konsultimit dhe ofrimit të ekspertizës për rishikimin dhe hartimit të akteve nënligjore.	Takime vlerësuese në Bashki/Qarku dhe aktorë të tjerë	5
3	Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet Inspektimit të ofruesve të shërbimeve shoqërore.	Inspektime të qendrave të përkujdesit shoqëror.	145

Vetëm gjatë vitit 2022, Drejtoria, ka realizuar:

- 34 Tryeza Teknike;
- Pjesmarrje në Ëorkshope, në nivel kombëtar, për promovimin e rolit të inspektoriatit të kujdesit shoqëror;
- 5 takime vlerësuese dhe konsultuese në Bashki/Qarku dhe aktorë të tjerë;

Këto aktivitete janë realizuar në partneritet me organizata, përfaqësi dhe agjensi ndërkombëtare si UNICEF Shqipëri, ILO, KE dhe UNDP përmes Programit “Leave No One Behind/Askush të mos mbetet pas (LNB2)”. Aktivitetet dhe ndërveprimet kanë mundësuar përfshirjen dhe kontributin e inspektimit të shërbimeve sociale në të gjitha forumet, tryezat, grupet e punës, që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, zhvillimin e politikave sociale, duke forcuar dialogun ndërinstitucional. Stafi i Drejtorisë ka kryer analiza dhe raporte për aktet e munguara apo për rishikimin e akteve nënligjore ekzistuese në fushën e kujdesit shoqëror dhe inspektimit të tyre. Gjithashtu, së bashku me këto agjensi ndërkombëtare, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka lobuar e vijon të llobojë për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit 121/2016, datë 24.11.2016, akte të lidhura me strukturën dhe funksionet e inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe të metodologjisë së inspektimit.

Kontrolli për zbatimin e kërkesave ligjore dhe vlerësimit të plotësimit të standarteve të përkujdesit shoqëror

Për gjatë vitit 2022, bazuar në Ligjin Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM 512 datë 31.5.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të shërbimeve shoqërore”, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore, në përmbushje të përgjegjësisë ligjore dhe në përputhje me prioritetin e saj, për garantimin e cilësisë së përkujdesit të ofruar nga aktorë publikë dhe jopublikë, ka realizuar, gjithësej 145 kontrole dhe vlerësime të plotësimit të standarteve të përkujdesit në Qendra/Njësi të shërbimeve të Kujdesit Social.

Në mënyrë të përmbledhur treguesit e arritur gjatë vitit 2022, në drejtim të Vlerësimit dhe inspektime të qendrave të përkujdesit shoqëror, janë:

Nr.	Treguesi	Realizuar
1	Inspektime të planifikuara të Qendrave/Njësive të përkujdesit social	135
2	Inspektime të paplanifikuara të Qendrave/Njësive të përkujdesit social	10
2.1	Vlerësimi i standarteve të përkujdesit për efekt liçensimi	6
2.2	Vlerësimi i standarteve të përkujdesit për procedurë verifikim ankese	1
2.3	Vlerësimi dhe informimi në Qendra të reja të evidentuara në terren.	3
3	Inspektime gjithësej	145

Përgjatë këtij vitit, në zbatim të planit të Inspektimit, në terren u konstatuan 15 Shërbime/Programe komunitare të ndërprera, joaktive, për shkak të përfundimit të Projekteve, ku veçojmë 2 raste të shërbimeve të përkujdesit komunitar në varësi të bashkisë, financimi i të cilave varej vetëm nga Fondi Social.

Gjithashtu, përgjatë punës në terren, u konstatuan 3 shërbime të reja komunitare, të pa identifikuar më parë. Sipas target grupeve dhe numrit të përfituesve, shërbimet e përkujdesit të inspektuara, vlerësuar përgjatë vitit 2022, prezantohen në tabelën në vijim.

Lloji i përkujdesit	Nr. Inspektimeve	Përfituesit								
		Fëmijë	PAK	Mosha III	Viktima apo rrezik	Familje	Gra/vajza	Të rinj	Individ në nevojë	Gjithësej
Rezidencial	36	209	162	261						632
Emergjent	17				189					189
Komunitar	92	2058	1463	725	347	176	942	141	2232	8084

Kështu, sikurse paraqitet edhe grafikisht, numri i përfituesit e shërbimeve të përkujdesit komunitarë është shumë herë më i lartë se në llojet e tjera të përkujdesit.

Përfituesit e shërbimeve sipas llojit të shërbimi




Për sa i përket klasifikimit të Qendrës/Shërbimit për nga financuesi apo administruesi i tyre, përgjatë këtij viti, u inspektuan:

- 60 Qendra/Shërbime publike;

- 85 Qendra/Shërbime jopublike, nga të cilat 29 janë organizata/misione të besimit fetar.

Bazuar në bazën e të dhënave të Drejtorisë, (sikurse është detajuar më lart), nga 485 shërbime dhe programe aktorë gjithësej, raporti publik dhe jopublik, mes tyre, rezulton në shifrat 162 publikë dhe 323 jopublikë, (33.3% me 66.6%). Gjithashtu, nënvizojmë se shërbimet komunitare numerikisht janë rritur ndër vitet e fundit, pasi në krijimin dhe administrimin e tyre është rritje numri i bashkive dhe projekteve të angazhuara në ofrimin e shërbimeve shoqërore. Në përputhje me këtë trend, u planifikuan dhe u realizuan më shumë inspektime në shërbimeve të përkujdesit komunitar, me prioritet ato të administruara nga Bashkitë. Kështu, raporti i inspektimit të shërbimeve publike me ato jopublike për gjatë vitit 2022, nuk ruan raportin e përgjithshëm të aktorëve, (33.3% publik dhe 66.6% jopublik), por është 41.4% inspektime të realizuara në ofrues publikë dhe 58.6% ofrues në ofrues jopublik, (grafiku në vijim).



Trajtimi Ankesave, kërkesave për Liçensim apo/dhe informacione

Së fundmi, lidhur me inspektimet, për vitin 2022, Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore ka trajtuar, verifikuar dhe raportuar në kohë, pranë MSHMS-së për 6 qendra të vlerësuara për efekt të procesit të liçensimit dhe për 1 rast për procedurë interpelance në Kuvend. Ndërsa nga Portali i Bashkëqeverisjes nuk është adresuar asnjë ankesë për vitin 2022. Gjithashtu, i janë dërguar periodikisht dhe në afat, Raporte të Përgjithshme MSHMS-së dhe titullarit të Bashkisë, të Këshillit të Qarkut apo/dhe të SHSSH, sipas territorit përkatës të inspektuar.

Përgjatë vitit 2022 janë përgatitur dhe dërguar Raporte/Analiza të veçanta për MSHMS-në dhe aktorë të interesuar, mbi vlerësimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror të mbështetura me Fond Social, apo në përmbushje të kërkesës së MSHMS-së, në interes “Të raportimit pranë Delegacionit European për plotësimin e Indikatorit IPA II Mbështetje Financiare “Përfshirja Sociale”.

Nga inspektimet e kryera gjatë vitit 2022, (pra në 145 Qendra/Shërbime/Njësi), përfshi këtu, inspektimet tematike të planifikuara, (135) dhe ato të paplanifikuara, (10), për procedura trajtimi të ankesës apo liçensimit, u konstatua se, përgjithësisht, janë plotësuar kërkesat proceduriale dhe treguesit e standarteve. Vetëm në 3 raste, (2 shërbime komunitare për moshën e tretë dhe 1 për PAK), është cënuar plotësimi i nivelit minimal të standarteve.

Në mënyrë të përmbledhur mangësitë e konstatuara janë në tabelën në vijim:

Nr.	Çështja sipas standartit	Nr. Qendrave/Shërbimeve			Nr. Detyrave të lëna
		Gjithësej	Publikë	Jopublikë	
1	Liçensimi	24	21	3	24
2	Aksesueshmëria	14	12	2	15

3	Ekipi profesionistëve	34	28	6	36
4	Mjedisi fizik i ofrimit të shërbimit	15	13	2	17
5	Dokumentacioni i Përfituesve	30	19	11	40
6	Dokumentacioni i Qendrës/Shërbimit	20	15	5	26
7	Mekanizmat e sigurisë dhe mbrojtjes	20	6	14	24
8	Ankimimi	33	9	24	33
9	Dosjet e stafit	27	15	12	34
10	Të tjera	19	12	7	23
11	Gjithësej detyra të lëna				272

Në konsideratë edhe të konstatimeve, rast pas rasti, në qendrat/shërbimet e inspektuara, analiza e konstatimeve dhe detyrave është si më poshtë:

- Përsa i përket pajisjes me Liçensë për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, bazuar në VKM 538, datë 26.05.2009 "Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", e ndryshuar, sikurse shikohet në tabelë, ajo rezultoi e pa plotësuar në 21 shërbime publike, nga të cilat në 17 raste janë shërbime të reja komunitare të krijuara nga bashkitë.
 - Mos pajisja me liçensë, e këtij grupi, konstatohet së pari të jetë për shkak të mosdijenisë për kërkesën ligjore të strukturave përgjegjëse lokale, dhe së dyti, me faktin se kërkon angazhimin e shumë strukturave të Bashkisë, pasi këto Qendra, në kuptimin ligjor nuk janë person juridik më vete, në varësi të Bashkisë, por më së shumti zgjatesa stafesh. Pajisja e tyre me liçensë kërkon ndërveprim të të specialistëve dhe strukturave të ndryshme të administratës së Bashkisë, përfshi edhe vendimarrje të Këshillit Bashkiak.
 - Ndërsa në 3 raste, shërbime jopublike të përkujdesit shoqëror janë Qendra/Shërbime të reja, me fillim aktiviteti 1-2 muaj para konstatimit, (inspektimit).
- Përsa i përket aksesueshmërisë është konstatuar në 6 raste mungesë e plotë. Nga këto raste, 5 i përkasin Qendrave publike. Janë lënë detyra edhe në 8 Qendra të tjera, lidhur me aksesueshmërinë e brendshme, si rivënie në funksionim të ashensorëve apo dhe plotësimin e mjediseve të brendshme me pajisje lehtësuese, veçanërisht për shërbimet e përkujdesit për të moshuarit.
- Përsa i përket konstatimeve/problematikave të lidhura me ekipin e profesionistëve, më së shumti janë konstatuar, në qendrat publike, dy problematika:
 - mos plotësimi i vendeve vakante;
 - mungesa e figurave profesionale, veçanërisht psikolog dhe logopedë në shërbimet e përkujdesit për PAK;
- Nevoja për investime meremetuese në Qendrat e shërbimit të përkujdesit shoqëror, publike, është përsëri evidente edhe për vitin 2022. Ajo është thuar në raport të barabartë në Qendrat e përkujdesit Rezidencial, (7), dhe përkujdesit Komunitar, (8).
- Lidhur me dokumentacionin e përfituesve, janë konstatuar mungesa në 30 Qendra përkujdesi. Përsëri këtu, rastet më të ndeshura janë në shërbimet komunitare publike, (14 të tilla), në varësi të bashkive. Mungesat nuk prekin thelbin/paketën e përkujdesit, ato janë konstatuar për dokumente specifike apo për rivlerësimin, nënshkrim formal të tyre.

- Lidhur me dokumentacionin e Qendrës, më së shumti shqetësime janë konstatuar në shërbimet publike. Problematika është e lidhur me hartime dhe afishime të dokumentacionit informues për përfituesit dhe vizitorët.
- Përsa i përket mekanizmit, (të treguesve), të sigurisë dhe të mbrojtjes, në tabelën më lart, konstatimet janë përmbledhëse, si për sigurinë fizike, ashtu edhe me mbrojtjen kundër diskriminimit, abuzimit, dhunës etj. Siguria fizike është vlerësuar dhe janë lënë detyra me raste të veçanta lidhur me pajisjen për çdo kati të strukturës me fikse zjarri, apo afishimin e planit të evakuimit. Ndërsa, me qëllim forcimin e mekanizmit të mbrojtjes së përfituesve nga dhuna, abuzimi, neglizhimi, në 15 qendra të përkujdesit komunitar, është lënë si detyrë hapja e regjistrit të incidenteve, si pjesë përbërëse e procedurave dhe dokumentimit të punës për mbrojtjen e përfituesve.
- Përsa i përket të drejtës së Ankimit dhe të hapjes së Kutisë së Ankimit, veçori për vitin 2022 është mos kryerja e kësaj procedure për çdo muaj. Më së shumti, u konstatua që komisioni përkatës, në përbërje të të cilit ka përfaqësues të strukturave lokale apo rajonale të Shërbimeve Sociale, nuk janë mbledhur dhe për pasojë Qendrat nuk kanë hapur vetë Kutitë e Ankimit. Konstatimet, më të shumta në numër, i përkasin 24 shërbimeve komunitare, nga 33 raste gjithësej. Inspektorët kanë lënë detyrë, rikthimin e procesit të Hapjes së Kutisë së Ankimit në normalitet.
- Përsa i përket konstatimeve lidhur me dosjen personale të stafit, problematika e konstatuar më së shumti janë të lidhura me plotësimin apo rivlerësimin e performancës së punonjësit dhe të Librezës shëndetësore të tij.

DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore ka qenë dhe ngelet një objektivi i vazhdueshëm i ISHPSHSH-së. Në këtë aspekt përmendim

- Trajnim për inspektorët e rinj, në lidhje me çështjet që mbulon inspektimi i punës.
- Trajtime për inspektorët e punës, në raport me problematikat që hasen në varësi të rajoneve dhe aktivitetit të subjekteve të inspektuara.
- Është zhvilluar një cikël trajnimi nga ekspertë të ILO-s, për specifikat e formave të reja të punës si telepuna, puna online etj
- Është zhvilluar trajnimi me temë “Eliminimi i dhunës dhe ngacmimeve seksuale në vendin e punës.
- Trajnimin e detyrueshëm tek ASPA për inspektorët e rinj për të marrë statusin e nëpunësit civil, në përfundim të periudhës së provës.

ÇËSHTJET LIGJORE

Proceset Gjyqësore


Spektori i Çështjeve Ligjore gjatë periudhës janar- dhjetor 2022 ka ndjekur 36 procese gjyqësore, të cilat kanë të bëjnë me sanksionet e vendosura nga inspektimet e kryera në subjekte të ndryshme si dhe procese gjyqësore me objekt marrëdhëniet e punës, apo arsye të tjera ku institucioni ka qenë i thirrur në gjykim si palë e tretë.

Të gjitha këto procese gjyqësore janë të iniciuara me kërkesë të palëve të tjera dhe ISHPSHSH në të gjitha rastet është palë e paditur.

Nga 36 procese gjyqësore:

- Në 18 raste gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë-padisë, që do të thotë që ISHPSHSH është palë fituese.
- Në 6 raste gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë-padisë që do të thotë që ISHPSHSH ka humbur procesin.
- 12 raste janë në gjykim.

Në 75 % rasteve për të cilat ka një vendim, Gjykata ka vendosur ISHPSHSH si palë fituese të procesit.



Ndikimet në këto rezultate


- Rritja e cilësisë së procesit të inspektimit si një proces i rregullt ligjor, si edhe i vendimarrjes si Komisionit
- Asistenca juridike e Drejtorive Rajoanle në rastet kur kanë qenë palë ndërgjyqëse
- Ndjekja me profesionalizëm e procesve gjyqësore.
- Ndjekja me jurist apo me një përfaqësues nga ISHPSHSH në çdo proces gjyqësor, duke mos lënë gjykim në mungesë.
- Provueshmëria me prova dhe fakte i gjetjeve të konstatuara gjatë inspektimit

Gjobat dhe ekzekutimi i tyre


Drejtoria Rajonale/Spektori i Inspektimit	Numër Gjobash	Vlerë (000)	Arkëtime të gjobave vendosur 2022	Komisioni Ankimit/Gjykata, gjoba të shfuqizuar, ndryshuar	
				Shfuqizuar	Ndryshuar
Tiranë-Rajoni I	45	7344	27	2	1
Spektori Tiranë	33	5264	23		
Spektori Durrës	12	2080	4		
Vlorë-Rajoni II	19	3138	10	1	1
Spektori Berat	4	1378	2		

Spektori Fier	6	510	1		
Spektori Vlorë	9	1250	7		
Dibër-Rajoni III	8	1830	1	1	
Spektori Dibër	5	1380	1		
Spektori Kukës	3	450			
Korçë-Rajoni IV	20	3174	8	1	
Spektori Korçë	14	2300	7		
Spektori Elbasan	6	874	1		
Shkodër-Rajoni V	17	6940	5	1	1
Spektori Shkodër	7	2700	5		
Spektori Lezhë	10	4240			
Gjirokastër-Rajoni VI	9	2520	4		
Spektori Gjirokastër	4	1400	4		
Spektori Sarandë	5	1120			
Drejtoria Qendrore	17	3,394	11		1
Total	135	28,340	66	6	4

Paraqitur me grafik ekzekutimi gjobave sipas rajoneve,



Krahasimisht me dy vite me parë kemi



Theksojmë se në për çdo rast sanksioni me gjobë kanë filluar procedurat e ekezekutimit.


Me qëllim vënien në ekzekutim të dënimeve administrative gjobë, janë përgatitur vërtetime për Drejtoritë Rajonale lidhur me ankimimin ose jo të subjekteve të sanksionuara nga inspektorët e punës dhe janë dërguar vendimet e Komisionit të Ankimit të ISHPSHSH-së, me qëllim paraqijen e tyre për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit për vjeljen e gjobave, apo njoftimin e subjektit për të bërë ekzekutim vullnetar duke i vënë në dispozicion mandatet e arkëtimit dhe kërkesën për likuidim vullnetar.

Ky proces mbi ndjekien e ekzekutimit të gjobave është vënë në fokus të Drejtorive Rajonale, ku edhe janë udhëzuar mbi mënyrën e ndjekies së tyre dhe i janë dërguar formate tip me qëllim unifikimin e kësaj praktike.

Për vitin 2022 janë 135 vendime përfundimtare me gjobë për shkelje të dispozitave ligjore.

Tipologjia e shkeljes e sanksioneve me gjobë:

- 26% shkelje të dispozitave të Ligjit 10237 “ Për sigurinë dhe shëndetin në punë “,
- 47.4% shkelje të dispozitave të Ligjit 7961, datë 1995 “ Kodi i Punës “, i ndryshuar
- 22 shkelje të dispozitave të Ligjit 9634 “ Për Inspektimin në punë “,
- 1.4% shkelje të dispozitave të Ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.
- 5.9% shkelje të dispozitave të Ligjit 9136 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.
- 97 % e gjobave të ekzekutuara janë likuiduar vullnetarisht nga subjektet.




Kanë vijuar arkëtimet e gjobave të viteve të shkuara 40 të tilla , me vlerë totale 8,283,470 lekë.

Nxitet ekzekutimi si më poshtë si dhe duke dhënë rol aktiv Komisionit të Ankimit.


- 1 • Ndiqet ekzekutimi edhe për gjobat që janë në proces gjyqësor, duke rritur efektivitetin e sanksionit
- 2 • Nxitet ekzekutimi vullnetar nëpërmjet dërgimit të kërkesave nga vete institucioni për ekzekutim vullnetar
- 3 • Unifikuar procedura e ekzekutimit, duke përdorur të gjitha Degët Rajonale të njëjtat formate dhe dokumenta bashkëlidhur

Komisioni i Ankimit të ISHPSHSH-së

Gjatë viti 2022 shënohet ulje e Vendimeve Përfundimtare të ankimuara ku i paraqesim si më poshtë,



Krahasimisht me një vit më parë vihet re ulje e ankimimeve ndaj gjobave.



Vendime të Komisionit të Ankimit

- Gjatë 2022 janë shqyruar 46 vendime ankimimi ndaj vendimeve përfundimtare ku në;
- Në 76 % të ankimeve të paraqitura Komisioni ka lënë në fuqi Vendim Përfundimtar.
- 28 % e vendimeve të Komisionit është ankuar në gjykatë.
- 85% të rasteve Gjykata ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit.

Përsa i përket njoftimit të gjobave në 100 % të rasteve subjektet kanë marrë dijeni për vendimin përfundimtar të inspektimit, duke përdorur edhe format e njoftimit publik.

- Në 100 % të rasteve subjektet kanë marrë dijeni për vendimin përfundimtar të inspektimit, duke përdorur edhe format e njoftimit publik.



- Është unifikuar procedura që ndiqet në rastet e njoftimit publik.

Gjatë vitit 2022 janë udhëzuar për zbatimin e drejtë të dispozitave të legjislacionit të punës dhe të ligjit procedural për rritjen e cilësisë së inspektimit, me qëllim që puna inspektuese të arrijë efektivitetin në mbrojtjen e interesave të ligjshme të palëve që rregullohen me legjislacionin e punës.

Ndryshimet Ligjore janë Referuar në MFE për mangësi të legjislacionit në fuqi dhe marrja pjesë në grupe pune .

Grupet ndërinstitucionale

- Takimi bilateral Kap 23 “Gjyqesori dhe te drejtat themelore”.
- Kap 2 “Liria e Levizjes se Punëtorëve”.

VII. AKTIVITETE DHE PUBLIKIME

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore nëpërmjet platformave të ndryshme të komunikimit online informon në kohë publikun, dhe ka gjithmonë parim garantimin e të drejtës së informimit. Platformat nëpërmjet të cilave shpërndahet ky informacion janë: email zyrtar: info@slj.gov.al, <https://inspektoratipunes.gov.al>, facebook: Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Promovimi dhe zbatimi i instrumentave ndërkombëtare të sigurisë dhe shëndetit në punë.

- Pjesëmarrje dhe përgatitja e materialeve në lidhje me zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara dhe përafrimin me legjislacionin e BE-së, nëpërmjet Grupeve të Punës Ndërminstrore për Integrimin European, për kapitujt, 19 ("Politikat Sociale dhe Punësimi"), 20 ("Ndërrmarjet dhe Politikat Industriale"), "Kriteri Ekonomik" dhe 28 ("Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik").
- Pjesëmarrje dhe përgatitja e materialeve për Nënkomitetin “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale” dhe “Tregtia, Industria, Doganat dhe Tatimet”, si dhe “Komiteti i Stabilizim Asocijimit”
- Në bashkëpunim me Organizatën e Punëdhënësve të aktivitetit fason “Pro Eksport”, kemi zhvilluar 2 tryeza të rrumbullakta përkatësisht në qarqet Shkodër dhe Durrës.

- Pjesëmarrje aktive në takime të ndryshme të organizuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Qendra e Aleancës Gjimore e Zhvillim, Qendra për të Drejtat në Punë, Qendra Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Kryqi i Kuq Shqiptar, sindikata të punëdhënësve dhe punëmarrësve, për promovimin dhe ndërgjegjësimin publik në raport me zbatueshmërinë e legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe të gjithë Legjislacionit të Punës në tërësi.
- Në kuadër të marjes së praktikave më të mira kemi zhvilluar një vizitë studimore pranë Inspektoratit të Punës në Greqi, si dhe pjesë e Konferencës Rajonale me Inspektoratet e Rajonit të Ballkanit Perëndimor me temë “Luftën kundër punës e padeklaruar” zhvilluar në Sarajevë të Bosnjë Hercegovinës. Këto aktivitete janë mundësuar në kuadër të Projektit “Esap II” financiar nga BE dhe ILO.

Brenda vitit 2022 me mbështetjen e Projektit Esap II, do të sigurojmë kryerjen e procesit të Programimit të Inspektimeve mbi bazë risku, tërësisht të automatizuar, të cilin e konsiderojmë një nga arritjet pozitive të procesit inspektues që shërben për rritjen e efektivitetit të të gjithë trupës inspektuese të Inspektoratit të Punës

Fushata Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2020-2022

Fushatat Europiane “Vende Pune të Shëndetshme” janë iniciativa dhe përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin për sigurinë dhe shëndetin në punë në të gjithë Europën.

Mesazhi i këtyre fushatave është i qartë – “Siguria dhe shëndeti në punë është shqetësimi i të gjithëve. Mire per ty. Mirë për biznesin.”

Fushatat janë më të mëdhatë e llojit të tyre në Europë dhe secila ka një temë të përcaktuar qartë, ku tema e fushatës 2-vjeçare 2020-2022 është “Lehtëso Ngarkesën” e cila lidhet me sëmundjet muskulo-skeletore në vendin e punës.

Mbajtur çdo vit në tetor (java kalendarike 43), Java Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë është pika kryesore e çdo fushate për Vende të Shëndetshme Pune.

Me qindra ngjarje ndërgjegjëse zhvillohen në të gjithë BE-në, ku dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore ka kryer një sërë aktivitete gjatë këtij muaji për të promovuar kushte të sigurta e të shëndetshme pune.

Vende Pune të Shëndetshme **LEHTËSO NGARKESËN**



www.healthy-workplaces.eu

#EUhealthyworkplaces



- Në kuadër të fushatës Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2020-2022 e udhëhequr nga Agjencia Europiane e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (EU-OSHA), nën sloganin “Vende Pune të shëndetshme, Lehtëso Ngarkesën”, janë kryer aktivitetet e mëposhtme:
- Shpërndarja e materialeve të fushatës në të gjitha Drejtoritë Rajonale të ISHPSHSH-së
- Trajtime informuese dhe këshilluese mbi mënyrën dhe procedurën e zhvillimit të kësaj fushate.
- Vizita inspektuese me bazë këshillimi në subjekte të ndryshme, mbi rreziqet e lidhura me qëndrimin, ekspozimin ndaj lëvizjeve të përsëritura ose në pozicione të lodhshme.
- Organizim dhe pjesëmarrje në tryezat e rrumbullakta sensibilizuese, informuese dhe ndërgjegjësuere me organizata të punëdhënësve, punëmarrësve, shkolla profesionale, institucione shtetërore dhe private, sindikata, persona përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe shoqëri civile.
- Përgatitja e materialit për videon pëmblylëse të kësaj fushate.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023

- Rritja cilësisë së inspektimit përmes përmirësimit të programimit të inspektimit mbi bazë risku, monitorim dhe bashkëpunim ndërinstitucional
- Përmirësimi i mëtejshëm dhe shtimi i funksionlleteve nëpërmjet zhvillimeve të reja të "Platformës Ndërgjegjëse" me mbështetjen e projektit ESAP 2.
- Forcimi i integritetit dhe etikës institucionale.
- Zhvillimi i ndërhyrjeve dhe objekteve të përcaktuara në Strategjinë Punësim dhe Aftësim 2023-2030.
- Implementimi i ndryshimeve ligjore në praktikën inspektuese të ISHPSHSH-së
- Promovimi i një culture parandaluese për vende pune të sigurta, të shëndetshme dhe produktive
- Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore në partneritet me UNICEF dhe UNDP, në kuadër të Programit 4 vjeçar "Leave No One Behind" LNB2, për vitin 2023, ka dakortësuar dhe do të realizojë aktivitete të përbashkëta apo të mbështetura nga këta partnerë.
- Garantimi i cilësisë së shërbimit të përkujdesit shoqëror nëpërmjet rishikimit dhe hartimit të standarteve të shërbimeve shoqërore.